

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshem,** Gjyqtarja **DIANA SINA,** me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarve R M dhe O M që të dytë nga Gj , për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 409 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Dep.përgjithshem në Gjakovë, PP.nr.1195/2017 të datës 23.10.2017, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datën **16.01.2018,** në prani të Prokurores se shtetit Dëshire Jusaj, të akuzuarve, të dëmtuarit G K , të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

1.I akuzuari **R M** , nga i ati B dhe e ëma B e gjinisë A i lindur me 18.07.1994 në Gj ku dhe tani banon në rrugën “...” nr..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, student, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R Kosovës.

2.I akuzuari **O M** , nga i ati B dhe e ëma B e gjinisë A i lindur me .... në Gj , ku dhe tani banon në rrugën “...” nr.5.. ka të kryer shkollën e mesme, i martuar-atë i 1 fëmije, me profesion elektrikist, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R Kosovës.

#### **J a n ë f a j t o r :**

**Sepse:** Me datën 03.08.2017 rreth orës 18:00 në rrugën “E Zh ” në Gj ,gjatë një kontrole policore rutinore, kanë ndalur automjetin e tipit “O Z ” me ngjyrë të kuqe, me targa regj.....-...., ku vozitësi R M njoftohet nga policet F H , L B dhe G K për shqiptimin e tiketës së gjobës për shkak se ka vendosur xhamat e errëta në veturë, për çka një gjë të tillë nuk e kishte të paraparë në dokumentin e automjetit, ashtu që me atë rast i pandehuri R reagon ndaj gjobës së shqiptuar duke iu thënë “Se do ta paguash ndryshe këtë tiketë, si dhe i pandehuri O pasi e pyet policin G se si quheni dhe me të kuptuar se është egjiptian i thotë “Ti qenke magjup”, duke vazhduar pastaj me fjalë të tjera fyese në atë mënyrë policet kërkojnë nga i njëjti që të del nga vetura ai refuzon, atëherë reagon me fjalët i pandehuri R “se e prekni ju O veç keq ka me ta qitë ty”, që fjala ishte për policin G , me të parë këtë policet reagojnë dhe me forcë e prangosin ku i dërgojnë për në stacionin policor për shkak të pengimit të tyre në kryerjen e detyrës zyrtare si polic të Kosovës.

- me të cilat veprime kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje, pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 409 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 4,41,49,50,51,73 dhe nenit 409 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-së, iu shqipton:

#### **DËNIM ME KUSHT**

1.Të akuzuarit **R M** dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

2.Të akuzuarit **O M** dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Detyrohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve procedurale penale, në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej **30,00.-Euro**, secili veç e veç, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Të dëmtuarit G K F H dhe L B – Pjesëtar të Stacionit policor në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1195/2017, të datës 23.10.2017, kundër të akuzuarve R M i dhe O M që të dytë nga Gj , për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 409 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj, në shqyrtimin fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

I akuzuari R M në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë deklaron , se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, për të cilën veprë jam penduar pa masë menjëherë pas kryerjes së veprës, të dëmtuarve pjesëtarëve të Stacionit policor në Gj ju kam kërkuar falje për veprimet e bëra, veprën e kam bërë duke mos menduar për pasojat e kryerjes së saj për të cilën jam penduar pa masë, shton se jam në gjendje të dobët materiale si dhe për herë të parë ndeshem me ligjin, andaj i propozoi gjykatës që të ketë parasysh rrethanat e lartë cekura me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

I akuzuari O M në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë deklaron, se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, edhe unë jam penduar për veprën e kryer, të dëmtuarve pjesëtarëve të Stacionit policor në Gjakovë ju kam kërkuar falje të cilët më kanë falur gabimin dhe të njëjtëve ju kam premtuar se veprën e tillë nuk do ta përsërisë, shton se jam në gjendje të dobët materiale, jam baba i një fëmije, jam mbajtës i familjes, si dhe për herë të parë ndeshem me ligjin, andaj i propozoi gjykatës që të ketë parasysh rrethanat e lartë cekura me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

I dëmtuari G K deklaron, se sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit ia le Gjykatës në vlerësim, ndërsa unë si palë e dëmtuar nuk kërkoj kompensimin e dëmit, që të dytë të akuzuarit menjëherë pas rastit në Stacionin policor kanë kërkuar falje, me arsyetim se veprën e kanë kryer në afekt nga neglizhenca e tyre me qëllim që të mos iu shqiptoi dënimin e veprës kundërvajtëse të kryer në vendin e ngjarjes, pas rastit jemi takuar disa herë dhe të njëjtit më kanë respektuar si mua ashtu edhe koleget e mij.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që të akuzuarit kanë pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe të njëjtit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet ne faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se të akuzuarit R M dhe O M ; Me datën 03.08.2017 rreth orës 18:00 në rrugën “E Zh” në Gj , gjatë një kontrolli policore rutinore, kanë ndalur automjetin e tipit “O Z” me ngjyrë të kuqe, me targa regj.,,.,, ku vozitësi R M njoftohet nga policet F H , L B dhe G K për shqiptimin e tiketës së gjobës për shkak se ka vendosur xhamat e errëta në veturë, për çka një gjë të tillë nuk e kishte të paraparë në dokumentin e automjetit, ashtu që me atë rast i pandehuri R reagon ndaj gjobës së shqiptuar duke iu thënë “Se do ta paguash ndryshe këtë tiketë, si dhe i pandehuri O pasi e pyet policin G. se si quheni dhe me të kuptuar se është egjiptian i thotë “Ti qenke magjup”, duke vazhduar pastaj me fjalë të tjera fyese në atë mënyrë policet kërkojnë nga i njëjti që të del nga vetura ai refuzon, atëherë reagon me fjalët i pandehuri Rinor “se e prekni ju O veç keq ka me ta qitë ty”, që fjala ishte për policin G., me të parë këtë policet reagojnë dhe me forcë e prangosin ku i dërgojnë për në stacionin policor për shkak të pengimit të tyre në kryerjen e detyrës zyrtare si polic të Kosovës.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga të akuzuarit, të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimit i fajësisë nga të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimit është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimit i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve: mosha e tyre e re në kohën e kryerjes së veprës, gjendjen e tyre të dobët ekonomike, pranimitin e fajësisë, sjelljet korrekte në Gjykatë, pendimin e tyre dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisin veprën e tillë apo të ngjashme, kërkim falje të dëmtuarëve, i dëmtuari G K nuk kërkon kompensim të dëmit si dhe i njëjti ju ka falë gabimin, e sidomos faktin se të akuzuarit për herë të parë ndeshen me ligjin, më parë nuk kanë qenë të dënuar, si rrethanë rënduese gjykata vlerësoi peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së tyre penale, andaj Gjykata të akuzuarve iu shqiptoi secilit veç e veç dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3(tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarit brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryejnë ndonjë veprë tjetër penale, me bindje se do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor, dhe shpenzimeve të procedurës penale, është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën paragraf 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**-Departamenti i përgjithshëm-**  
**P. nr.722/17 më datë 16.01.2018**

**Sekretarja juridike,**  
**Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**  
**Diana Sina**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.